

**RAPORT I PËRKOHSHËM**  
**27 gusht – 12 shtator 2018**

**14 shtator 2018**

**I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR**

Më 30 korrik, Kuvendi, pa pjesëmarrjen e partisë kryesore opozitare, solli vendim për të mbajtur referendum konsultativ më 30 shtator në lidhje me marrëveshjen bilaterale me Republikën e Greqisë, me ç'rast dispozita kyçe e marrëveshjes bën thirrje ndryshimin e emrit kushtetues të vendit në “Republika e Maqedonisë Veriore”.

Pyetja e referendumit për të cilën do të duhet të vendosin votuesit do të jetë, “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO duke e pranuar Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?” Referendumi do të konsiderohet i vlefshëm nëse në të marrin pjesë shumica e votuesve të regjistruar.

Referendumi kryesisht është i rregulluar me Kushtetutën e vitit 1991, Ligjin për referendumin dhe iniciativat qytetare (Ligji për referendumin) të vitit 2005 dhe me Kodin zgjedhor të vitit 2006. Korniza ligjore për referendumin nuk ka dispozita konkrete për disa elemente kyçe të procesit, duke i përfshirë edhe rregullat e fushatës. KSHZ-ja ka futur rregulla të veçanta për ta qartësuar kornizën ligjore për këtë referendum.

Me ndryshimet e Kodit zgjedhor të bëra në korrik të vitit 2018 u krijua Komisioni i përkohshëm shtetëror i zgjedhjeve (KSHZ) me mandat gjashtëmuor, ku të gjithë anëtarët janë të emëruar nga partitë politike. KSHZ-ja ka mbajtur mbledhje të rregullta publike dhe i ka publikuar në kohë në ueb-faqen e saj të gjitha procesverbalet, si dhe shumicën e vendimeve kyçe dhe informatave.

Të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është marrë kjo e drejtë ligjore me vendim gjyqësor. Lista zgjedhore u mbyll më 7 shtator dhe përmban 1.806.336 votues me të drejtë vote, nga të cilët 2.694 janë regjistruar në mënyre aktive për votim jashtë vendit. Shumica e bashkëbiseduesve të MVR-së së ODIHR-it nuk kanë ngritur shqetësime të mëdha në lidhje me saktësinë e listës zgjedhore, edhe përkundër rëndësisë për ta arritur kufirin e pjesëmarrjes së votuesve në referendum.

Periodha zyrtare e fushatës filloi më 30 korrik, në ditën e shpalljes së referendumit. Megjithatë, shumica e palëve të interesuara njoftuan se fushatën do ta fillojnë më 10 shtator. Funkionarët e qeverisë, liderët e huaj dhe përfaqësuesit edhe të BE-së edhe të NATO-s kanë mbajtur fjalime publike për dobritë e integritimit.

Edhe pse momentalisht nuk ka ndonjë fushatë aktive “Kundër”, 28 shoqata qytetare dhe një parti politike, e cila momentalisht nuk është e përfaqësuar në Kuvend, angazhohen për bojkot me qëllim që të pengojnë që referendumi ta arrijë 50 për qindëshin e nevojshëm të pjesëmarrjes së votuesve në referendum. Fushata për bojkot ka qenë aktive kryesisht në mediat sociale, shpeshherë duke përdorë gjuhë nxitëse.

Bashkëbiseduesit e MVR-së së ODIHR-it e informuan MVR-në se atmosfera në të cilën veprojnë gazetarët është përmirësuar gjatë viteve të fundit; megjithatë, deri tani nuk janë implementuar

reforma strukturore mediatike. Korniza ligjore që e rregullon sjelljen e mediave gjatë referendumit nuk është e qartë sa duhet. Më 3 shtator MVR-ja e ODIHR-it filloi monitorimin cilësor dhe sasior mediatik të 10 kanaleve televizive.

## II. HYRJE

Në përgjigje të ftesës nga Ministria për Punë të Jashtme, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) e krijoi Misionin për vëzhgimin e referendumit (MVR) më 27 gusht, për ta vëzhguar referendumin e 30 shtatorit. MVR-ja e OSBE/ODIHR-it, e udhëhequr nga Ambasadori Jan Petersen, përbëhet nga ekipi kryesor me 13 ekspertë që është i vendosur në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin. Anëtarët e misionit janë siguruar nga 18 vende pjesëmarrëse të OSBE-së. Nga vendet pjesëmarrëse është kërkuar që të sigurojnë 250 vëzhgues afatshkurtër për ta vëzhguar votimin e hershëm më 29 shtator dhe hapjen, votimin, numërimin dhe nxjerrjen e votave më 30 shtator.

## III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016, partia e atëhershme në pushtet, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) e fitoi numrin më të madh të deputetëve, mirëpo nuk arriti të sigurojë mbështetje të mjaftueshme për të formuar qeveri, pasi që Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) dhe partitë e tjera etnike shqiptare u rreshtuan me Lidhjen Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM). Kryetari ia dha mandatin për të formuar qeveri LSDM-së dhe BDI-së, edhe atë në fund të periudhës së trazirave intensive politike. Koalicioni i ri në pushtet e konsolidoi pozicionin e tij kur fitoi kontroll mbi shumicën e komunave në zgjedhjet lokale të vitit 2017.<sup>1</sup>

Anëtarësimi i vendit në Bashkimin Evropian (BE) dhe në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), është bllokuar historikisht si rezultat i mungesës së konsensusit në mesin e vendeve anëtare të këtyre organizatave për shkak të kontestit në lidhje me emrin e vendit. Më 17 korrik të vitit 2018, pas një viti negociatash intensive, vendi nënshkroi marrëveshje bilaterale me Greqinë, dhe nëse ajo miratohet, ai do ta ndërrojë emrin e tij kushtetues në “Republika e Maqedonisë Veriore”<sup>2</sup>. Vendimi për të mbajtur referendum konsultativ për miratimin e marrëveshjes u soll në Kuvend më 30 korrik, me 68 vota “për” dhe asnjë “kundër”.<sup>3</sup> Përfaqësuesit e opozitës nuk ishin të pranishëm në votim. Që referendumi të konsiderohet i suksesshëm, në të duhet të marrin pjesë shumica e votuesve të regjistruar.

Implementimi i marrëveshjes nga shumë njerëz konsiderohet si parakusht për integritim në BE dhe NATO, dhe shumë bashkëbisedues të MVR-së së ODIHR-it sugjeruan se marrëveshja do të ketë edhe ndikim më të gjerë mbi stabilitetin politik të rajonit.<sup>4</sup> Edhe përfaqësuesit e BE-së edhe ata të NATO-s, duke përfshirë edhe udhëheqësinë e tyre, planifikojnë ta vizitojnë vendin gjatë javëve të ardhshme për t’i theksuar dobitë e integritimit për qytetarët. Pas referendumit, për ndryshimet

<sup>1</sup> Nga 81 komuna, LSDM-ja i fitoi kryetarët e komunave në 57 prej tyre, VMRO-DPMNE-ja në pesë, BDI-ja në dhjetë, Aleanca për Shqiptarët në tre, Lëvizja BESA në një, Partia Demokratike e Shqiptarëve në një, dhe Partia Demokratike e Turqve në një komunë.

<sup>2</sup> Shih [tekstin e plotë të marrëveshjes bilaterale](#).

<sup>3</sup> Disa iniciativa u parashtruan në Gjykatën Kushtetuese, njëra nga të cilat është të shqyrtohet kushtetutshmëria e vendimit për të mbajtur referendum konsultativ. Gjykata Kushtetuese nuk ka afat ligjor për ta sjellë vendimin e saj, por bëri me dije se do të përpiqet të vendosë para 30 shtatorit. Gjykata refuzoi t’i japë kopje të iniciativave MVR-së.

<sup>4</sup> Në samitin e saj në korrik të vitit 2018, NATO-ja i bëri ftesë zyrtare vendit që t’i fillojë negociatat për anëtarësim, [me kusht që të implementohet marrëveshja me Greqinë](#). BE-ja ngjashëm ka bërë me dije se [fillimi i bisedimeve për anëtarësim është i lidhur me zgjidhjen e kontestit të emrit](#).

kushtetuese do të nevojitet votim me shumicë prej dy të tretave në Kuvend. Pas miratimit të amendamenteve, marrëveshja do të duhet të miratohet nga Parlamenti i Greqisë.

#### IV. KORNIZA LIGJORE

Referendumi kryesisht është i rregulluar me Kushtetutën e vitit 1991 (e ndryshuar për herë të fundit në vitin 2011), Ligjin për referendumin dhe iniciativat qytetare (Ligji për referendumin) të vitit 2005 dhe me Kodin zgjedhor të vitit 2006 (të ndryshuar për herë të fundit në vitin 2018).<sup>5</sup> Edhe pse Ligji për referendumin i përcakton rregullat themelore për procesin e referendumit, ai ka mungesë të detajeve për çështje të caktuara thelbësore.<sup>6</sup> Ligji për referendumin parasheh se dispozitat e Kodit zgjedhor vlejné edhe për referendumin, nëse nuk është përcaktuar ndryshe.

Megjithatë, edhe pse do të vlejné dispozitat e Kodit zgjedhor për administratën zgjedhore dhe për regjistrimin e votuesve, KSHZ-ja e informoi MVR-në e ODIHR-it se rregullat për zhvillimin dhe financimin e fushatës nuk vlejné për referendumin.<sup>7</sup>

KSHZ-ja ka miratuar rregulla për t'i qartësuar disa aspekte të kornizës ligjore, duke përfshirë definimin dhe kornizën kohore për zhvillimin e fushatës së referendumit, si dhe procedurat për votimin jashtë vendit, zgjidhjen e kontesteve dhe procedurat e ditës së votimit.<sup>8</sup>

Ligji për referendumin kërkon që çështja për të cilën vendoset “të jetë e formuluar saktë dhe në mënyrë të padyshimtë që qytetarët të mund të përgjigjen me ‘për’ ose ‘kundër’”. Pyetja që do të paraqitet në fletëvotim thotë “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO duke e pranuar Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?” Disa bashkëbisedues të MVR-së së ODIHR-it i shprehën shqetësime për natyrën komplekse të pyetjes, fokusin për integrimin edhe në BE edhe në NATO, dhe mungesën e përmendjes së qartë të ndryshimit të emrit kushtetues të vendit.

#### V. ADMINISTRIMI I REFERENDUMIT

Referendumi do të administrohet nga administrata në tre nivele, që përbëhet nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (KSHZ), 80 Komisione zgjedhore komunale (KZK), Komisioni zgjedhor për Qytetin e Shkupit, dhe rreth 3,480 Këshilla zgjedhorë (KZ). Përveç kësaj, do të krijohen edhe 33 KZ në Përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK) për votimin jashtë vendit, dhe një në KSHZ për ta administruar votimin e anëtarëve të KZ-ve që janë shpërndarë në ato PDK.

Me ndryshimet e Kodit zgjedhor të bëra në korrik të vitit 2018 u krijua KSHZ-ja e përkohshme me mandat gjashtëmujor që përbëhet nga shtatë anëtarë, tre nga të cilët janë

<sup>5</sup> Në ligjet e tjera bëjnë pjesë Kodi Penal, Ligji për tubimet publike, Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për kontestet administrative, Ligji për financimin e partive politike, Ligji për mediat dhe Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike.

<sup>6</sup> Për shembull, dispozita ligjore përmban afat të fundit për zhvillimin e fushatës, të drejtën e propozuesit të autorizuar që të zhvillojë fushatë me shpenzimet e veta, dhe të drejtën e qytetarëve për të parashtruar kundërshtime, por nuk thotë gjë për çështjet e rëndësishme siç është definimi i fushatës së referendumit, të drejtat dhe rregullat e individëve dhe subjekteve të tjera për të zhvilluar fushatë, dhe mundësinë e propozuesit të autorizuar që të parashtrorë kundërshtime. Këto çështje janë trajtuar në rregullore të ndryshme të KSHZ-së.

<sup>7</sup> KSHZ-ja i sqaroi MVR-së së ODIHR-it se termi “fushatë zgjedhore” në Kodin zgjedhor ka të bëjë me kandidatët dhe partitë politike dhe për këtë arsye nuk vlen për aktivitetet e fushatës së referendumit.

<sup>8</sup> Rregullorja e KSHZ-së për përgatitjen, organizimin dhe administrimin e referendumit në nivel shtetëror (rregullorja) thekson se Ligji për referendumin nuk është i harmonizuar me Kodin zgjedhor.

gra.<sup>9</sup> Të gjithë anëtarët u emëruan nga partitë politike, katër nga koalicioni në pushtet, duke përfshirë nënkryetarin, dhe tre nga opozita, duke përfshirë kryetarin.<sup>10</sup> Përveç kësaj, Kodi zgjedhor parasheh emërimin e zëvendës-sekretarit të përgjithshëm, mirëpo kjo pozitë akoma nuk është definuar, e as që është plotësuar.

KSHZ-ja ka mbajtur mbledhje të rregullta publike, si dhe takime të tjera pune të cilat nuk janë të hapura për vëzhguesit ose për publikun. Mbledhjet publike janë mbajtur në mënyrë efikase dhe kolegjinale. Deri tani, KSHZ-ja ka miratuar rregullore për administrimin e referendumit, ka bërë njoftime për mbledhjet zyrtare, dhe në kohë i ka miratuar procesverbalet e mbledhjeve paraprake. KSHZ-ja i ka vendosur shumicën e vendimeve të saj dhe informatat kyçe në ueb-faqen e saj.<sup>11</sup>

KZK-të përbëhen nga pesë anëtarë (dhe pesë zëvendës), të cilët kanë mandat pesëvjeçar dhe zgjidhen në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve publikë. KZK-të e mbikëqyrin administrimin e referendumit në çdo komunë, i emërojnë dhe i trajtojnë KZ-të, dhe i menaxhojnë përgatitjet e tjera teknike. KZ-të përbëhen nga tre anëtarë (dhe tre zëvendës), të cilët zgjidhen në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve publikë dhe janë përgjegjës për menaxhimin e vendotimeve dhe zhvillimin e votimit dhe procedurat e numërimit të votave.<sup>12</sup> Për referendumin, KZ-të nuk do të përfshijnë dy anëtarë të përkohshëm të emëruar nga partitë, siç parashihet në Kodin zgjedhor për zgjedhjet e rregullta.

KSHZ-ja është e autorizuar për t'i trajnuar anëtarët e organeve më të ulëta për menaxhim të zgjedhjeve. Për shkak të vonesës në finalizimin e përmbytjes së doracakut për trajnim, KSHZ-ja nuk do t'i përmbahet orarit të saj fillestar për trajnim. KSHZ-ja do t'i trajtojë KZK-të, të cilat, pastaj, do të mbajnë trajnime për KZ-të. KSHZ-ja do të bëjë edukimin e votuesve në lidhje me procedurat e ditës së referendumit dhe për atë se si ta gjejnë vendvotimin e tyre.

## VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Sipas Kushtetutës, qytetarët që kanë mbushur 18 vjet kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është marrë kjo e drejtë ligjore me vendim gjyqësor. Në bazë të Kodit zgjedhor, vetëm personat me adresë të paraqitur dhe me letërnjoftim të vlefshëm ose me pasaportë biometrike janë përfshirë në regjistrin e votuesve.

Regjistrimi i votuesve për votimin në vend është pasiv. Listat zgjedhore përpilohen nga KSHZ-ja në bazë të të dhënave nga regjistrat e ndryshëm qytetarë dhe të popullatës. Këqyrja publike e listave zgjedhore u bë prej datës 9 deri më 23 gusht, kur votuesit kishin mundësi t'i kontrollojnë të dhënat e tyre onlajn dhe të dorëzojnë kërkesa në zyrat rajonale të KSHZ-së për shtim, fshirje ose korrigjim të informatave të tyre personale.<sup>13</sup> KSHZ-ja e mbylli listën zgjedhore më 7 shtator dhe

<sup>9</sup> Që nga Marrëveshja e Përzhinës e vitit 2015 dhe ndryshimet e pastajme të Kodit zgjedhor, KSHZ-ja përbëhej nga gjashtë anëtarë të emëruar politikisht dhe tre anëtarë profesionalë, deri sa ata dhanë dorëheqje në dhjetor të vitit 2017 për shkak të skandalit të korrupsionit.

<sup>10</sup> Tre nga anëtarët e rinj kanë përvojë të mëparshme me administratën zgjedhore, duke përfshirë edhe një ish-kryetar të KSHZ-së, shefi i regjistrit të votuesve, si i punësuar në KSHZ dhe një anëtar i KZK-së.

<sup>11</sup> Sipas nenit 77 të Rregullores së KSHZ-së, të gjitha aktet e miratuara nga Komisioni duhet të publikohen në ueb-faqen e tij. Nga shtatë mbledhjet e para të KSHZ-së, nga gjithsej 13 vendime, 4 ende nuk janë publikuar, kryesisht për çështje administrative.

<sup>12</sup> Anëtarët e KZK-ve dhe të KB-ve janë emëruar në vitin 2017 me mandat pesëvjeçar, respektivisht katërvjeçar.

<sup>13</sup> Gjithsej 5.641 votues kanë ardhur personalisht për t'i kontrolluar informatat e tyre personale, që rezultoi me 94 shtime, 295 fshirje dhe 74 korrigjime.

lista përfundimtare përfshin 1.806.336 votues me të drejtë vote.<sup>14</sup> Ministria për Punë të Jashtme e informoi KSHZ-në se 2.694 votues janë regjistruar për votim jashtë vendit.<sup>15</sup>

Duke vepruar në bazë të një rekomandimi të mëparshëm të ODIHR-it, autoritetet filluan një operacion për rinovimin e dokumenteve me afat të kaluar të personave të mbyllur në institucionet ndëshkuese. Kjo iniciativë rezultoi me lëshimin e 260 letërnjoftimeve të reja. Përveç kësaj, Ministria e Punëve të Brendshme ka premtuar se do ta përshejtojë procesin e rinovimit për të gjithë votuesit që kanë dokumente me afat të kaluar dhe se zyrat e saj do të jenë të hapura gjatë fundjavës së referendumit për t'u mundësuar votuesve që t'i marrin letërnjoftimet e reja.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVR-së së ODIHR-it pranojnë se ka çështje të pazgjidhura që kanë të bëjnë me saktësinë e listave zgjedhore. Megjithatë, shumica e palëve të interesuara nuk e kanë përmendur çështjen e saktësisë së listës zgjedhore si një shqetësim të madh për referendumin, pavarësisht nga rëndësia e arritjes së kufirit të pjesëmarrjes së votuesve prej 50 për qind.

## VII. AMBIENTI I FUSHATËS DHE FINANCIMI I FUSHATËS

KSHZ-ja njoftoi se periudha zyrtare e fushatës filloi më 30 korrik, në ditën e shpalljes së datës së referendumit, por të gjitha palët e interesuara deklaruan se do ta fillojnë fushatën më 10 shtator.<sup>16</sup> Fushata "Për" deri më tani është fokusuar kryesisht në integrimin në BE dhe NATO, dhe ka pasur një shkallë të lartë të përfshirjes ndërkombëtare, me liderë të huaj dhe përfaqësues edhe të BE-së edhe të NATO-s, që e vizitojnë Shkupin për ta promovuar marrëveshjen bilaterale dhe për ta inkurajuar pjesëmarrjen në referendum.<sup>17</sup>

Kuvendi, si propozues zyrtar i referendumit, do ta udhëheqë fushatën "Për". Qeveria ka krijuar një ueb-faqe dedikuar fushatës së referendumit me mesazhin "*Dil për Maqedoninë Evropiane*",<sup>18</sup> ndërsa kryeministri dhe ministrat kanë zhvilluar takime informuese me votuesit anëmbanë vendit.<sup>19</sup> Përveç kësaj, LSDM-ja është bashkuar me mbi 100 organizata, kryesisht të shoqërisë civile, për ta përkrahur votën "Për". Disa nga këto organizata zhvillojnë fushata të veçanta duke u fokusuar në tema specifike që lidhen me mandatet e tyre individuale. Përderisa VMRO-DPMNE-ja ka deklaruar se e kundërshton marrëveshjen për emrin, duke e përshkruar atë si "kapitullim", udhëheqësit e partisë e potencojnë mbështetjen e tyre të vazhdueshme për anëtarësimin në BE dhe NATO. Më 11 shtator partia njoftoi se votuesit duhet "të votojnë sipas ndërgjegjes së tyre".<sup>20</sup>

Edhe pse deri tani nuk ka fushatë aktive "Kundër", 28 asociacione qytetare dhe një parti politike, e cila momentalisht nuk është e përfaqësuar në Kuvend, angazhohen për bojkot për të penguar që referendumi ta arrijë 50 për qindëshin e nevojshëm të pjesëmarrjes së votuesve në referendum.

<sup>14</sup> Lista përfundimtare zgjedhore për zgjedhjet lokale të vitit 2017 përfshinte 1.814.644 votues të regjistruar.

<sup>15</sup> Votimi do të mbahet në 33 nga 52 PDK, pasi 5 prej tyre nuk morën asnjë kërkesë, ndërsa 14 kishin më pak se 10 kërkesa.

<sup>16</sup> Kjo datë përputhet fillimin e pushimit të deputetëve, e po ashtu mundëson 20 ditë për zhvillimin e fushatës, në përputhje me nenin 69-a(2) të Kodit zgjedhor.

<sup>17</sup> Delegacioni i Bashkimit Evropian [zhvillon aktivite për komunikim me komunitetin](#) nën sloganin "*Imagjino të ardhmen e përbashkët*". Sekretari i përgjithshëm i NATO-s tha publikisht gjatë [vizitës së tij në vend më 6 shtator](#), "E di se disa njerëz në vend mendojnë se mund të thonë 'jo' në referendum, por 'po' për NATO-n dhe BE-në. Nuk ka alternativë të tillë. Opsioni se Marrëveshja mund të refuzohet, e të anëtarësoheni në NATO është iluzion".

<sup>18</sup> [Ueb-faqja e qeverisë për fushatën e referendumit](#) përmban orar të ngjarjeve publike.

<sup>19</sup> Këto takime janë mbajtur në Berovë, Gostivar, Kriva Pallankë, Krushevë, Kumanovë, Ohër, Shkup, Strumicë, dhe Tetovë.

<sup>20</sup> Shih [përmbledhjen e deklaratës në gjuhën angleze](#), e cila [e plotë gjendet](#) në faqen e partisë në Facebook.

Fushata për bojkot ka qenë aktive kryesisht në mediat sociale dhe shpeshherë ka përdorur gjuhë nxitëse.

Qeveria i ka ndarë Kuvendit 80 milionë denarë (rreth 1.3 milionë euro) për t'i harxhuar për reklama në media gjatë fushatës së referendumit. Një komision koordinues i kryesuar nga kryetari i Kuvendit, ku bëjnë pjesë të gjithë zëvendës-kryetarët e Kuvendit dhe koordinatorët e grupeve parlamentare, do të jetë përgjegjës për t'i paguar drejtpërdrejt stacionet televizive për kohën e transmetimit. VMRO-DPMNE-ja e kritikoi këtë vendim dhe i refuzoi mjetet financiare të qeverisë, duke thënë se nuk është në interes të qytetarëve të përdoret financimi publik.<sup>21</sup> 71 deputetët që deklaruan se do të bënin fushatë për qëndrimin "Po" mund të dorëzojnë reklama ose të propozojnë individë për t'iu bashkuar atyre për ta përkrahur referendumin duke e përdorur kohën e blerë për transmetim.

Përveç kësaj, partitë dhe pjesëmarrësit e tjerë mund t'i vetëfinancojnë fushatat e tyre përmes donacioneve private. Megjithatë, rregullorja e KSHZ-së parasheh që vetëm Kuvendi si propozues zyrtar të dorëzojë raport financiar për fushatën, në afat prej 30 ditësh nga dita e referendumit. Disa palë të interesuara ia shprehën shqetësimet e tyre MVR-së së ODIHR-it në lidhje me mungesën e transparencës që rezulton nga rregullimi i kufizuar i financimit të fushatës. Disa palë të interesuara i shprehën shqetësime MVR-së së ODIHR-it për presionin e mundshëm ndaj nëpunësve shtetërorë për të votuar dhe për keqpërdorimin e burimeve shtetërore në fushatën e qeverisë.

## VIII. MEDIAT

Ambienti mediatic përbëhet nga një numër transmetuesish që funksionojnë, shpesh me vështirësi financiare, në një treg relativisht të vogël. Disa transmetues e informuan MVR-në e ODIHR-it se atmosfera në të cilën veprojnë mediat dhe gazetarët paksa është përmirësuar gjatë viteve të fundit, edhe pse mediat të nënshtruara ndaj ndikimit politik. Qeveria ka hartuar ndryshime të kornizës ligjore që i rregullon mediat, me të cilat synohet të përmirësohet ambienti mediatic, por ende nuk janë zbatuar reforma strukturore. Televizioni mbetet burimi më i rëndësishëm i informimit politik, e më pas vijnë burimet në internet.

Korniza ligjore që e rregullon sjelljen e mediave gjatë fushatës së referendumit nuk është e qartë për shkak të udhëzimeve kundërshtuese nga institucionet relevante.<sup>22</sup> Rregullorja e KSHZ-së, e lëshuar më 1 gusht, bën dallim midis "propozuesit të autorizuar" (Kuvendit) dhe të gjitha subjekteve të tjera, dhe urdhëron që mediat hapësirën e veçantë për fushatën t'ia ofrojnë Kuvendit. Megjithatë, Udhëzimi i mëvonshëm i miratuar nga Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike (ASHAAM) parasheh qasje të barabartë në media për çdo kë që angazhohet në fushatën për referendumin.

Ky udhëzim i ASHAAM-it përcakton se radiostacionet e stacionet televizive mund t'i kushtojnë gjithsej 9 minuta në orë reklamimit që ka të bëjë me referendumin, përveç maksimumit prej 12 minutash të parapara për reklamën e rregullta komerciale.<sup>23</sup> Disa kanale televizive publikisht shprehën pakënaqësi për Udhëzimin e ASHAAM-it dhe kërkuan që t'u lejohet të shesin reklama për fushatën jashtë hapësirës së dedikuar 9-minutëshe për ta maksimizuar mundësinë e tyre

<sup>21</sup> 40 për qind e mjeteve financiare të dedikuara për opozitën do t'i kthehen qeverisë.

<sup>22</sup> Me ndryshimet e paradokohshme të Kodit zgjedhor (të miratuara më 25 korrik) u fut kompetenca e KSHZ-së për t'i rregulluar dhe për t'i futur sanksionet ndaj mediave elektronike, gjë që shkaktoi shqetësi në radhët e shoqërisë civile. Megjithatë, këto ndryshime do të hyjnë në fuqi pas referendumit.

<sup>23</sup> Këto 9 minuta janë ndarë në dy pjesë të barabarta – nga 4 minuta e 30 sekonda secila pjesë – njëra për subjektet që zhvillojnë fushatë për përgjigjen "Po" të referendumit, dhe tjetra për subjektet që zhvillojnë fushatë për përgjigjen "Kundër" ose që angazhohen për bojkotimin e tij.

komerciale. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë po ashtu shprehi shqetësim se pagimi i reklamave politike në media me mjete publike do ta përforcojë ndikimin e partive politike mbi mediat dhe raportimin e tyre për proceset politike.

Më 3 shtator, MVR-ja e ODIHR-it filloi monitorimin cilësor dhe sasior mediatic të 10 kanaleve televizive për mbulimin nga ana e tyre të procesit të referendumit.<sup>24</sup>

## IX. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

Qytetarët dhe përfaqësuesit e autorizuar të propozuesit lejohet të parashtrijnë kundërshtime në KSHZ brenda 24 orëve në lidhje me parregullsitë në procedurat e ditës së votimit dhe nxjerrjen e rezultateve dhe të ankohen ndaj vendimeve të KSHZ-së në Gjykatën Supreme brenda 48 orëve.<sup>25</sup>

KSHZ-ja e informoi MVR-në e ODIHR-it se do të përdoret sistem elektronik për menaxhimin e rasteve dhe të kundërshtimeve, siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor, për menaxhimin e kundërshtimeve për referendumin. Deri më tani KSHZ-ja nuk ka pranuar asnjë kundërshtim.

KSHZ-ja i trajton kundërshtimet në lidhje me përbërjen e organeve zgjedhore dhe regjistrimin e votuesve. Entë shtetëror për revizion (ESHR) dhe Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) janë përgjegjëse për kundërshtimet që kanë të bëjnë me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, respektivisht.<sup>26</sup> Ndaj vendimeve të këtyre institucioneve për këto çështje mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Administrative. Kundërshtimet për shkeljet që kanë të bëjnë me fushatën që konsiderohen çështje penale ose civile duhet të parashtrohen në gjykatat themelore. KZK-të nuk kanë kompetencë mbi ankesat për referendumin.

Sipas Kodit Zgjedhor, ankesat kundër vendimeve të KSHZ-së në lidhje me regjistrimin e votuesve shqyrtohen nga Gjykata Administrative. Megjithatë, sipas rregullores së KSHZ-së, kjo kompetencë është bartur në Gjykatën Supreme.<sup>27</sup>

## X. VËZHguesit QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi zgjedhor dhe rregullat e KSHZ-së parashohin vëzhgim të referendumit nga vëzhguesit ndërkombëtarë dhe ata qytetarë. Vetëm organizatave të vendit që janë themeluar së paku një vit para referendumit dhe në statutin e të cilave është përfshirë parimi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, u lejohet të akreditojnë vëzhgues.<sup>28</sup> Sipas kornizës ligjore, vetëm "propozuesi" i referendumit, në këtë rast Kuvendi, lejohet të emërojë një përfaqësues të posaçëm për ta vëzhguar punën e administratës së referendumit në çdo komision dhe në çdo vendvotim.

Dy organizata të mëdha qytetare vëzhguese tashmë e kanë filluar vëzhgimin e tyre. MOST-i ka vëzhgues afatgjatë të pranishëm në çdo komunë, që i vëzhgojnë përgatitjet administrative dhe

<sup>24</sup> Monitorimi fokusohet në programet që emetohen në periudhën me shikim më të madh (18:00 - 24:00) nga kanalet televizive publike *RTM1, RTM2, Kanali i Kuvendit* dhe kanalet televizive private *Alfa, Alsat-M, Kanal 5, Sitel, Telma, TV 21* dhe *TV 24 Vesti*.

<sup>25</sup> Kjo mundësi për ankesë ndryshon nga ajo në Kodin Zgjedhor, sipas të cilës Gjykata Administrative është shkalla më e lartë për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.

<sup>26</sup> KSHPK-ja momentalisht nuk funksionon pasi të gjithë anëtarët kanë dhënë dorëheqje dhe ende nuk janë zëvendësuar.

<sup>27</sup> Rregullorja e KSHZ-së nuk e përcakton bazën ligjore për këtë ndryshim të kompetencës. Ligji për referendumin nuk parasheh kompetencë të Gjykatës Supreme për kundërshtimet për regjistrimin e votuesve.

<sup>28</sup> Më 24 gusht të vitit 2018, KSHZ-ja miratoi një Kod të veçantë të sjelljes për vëzhgimin e referendumit.

fushatën. Në ditën e referendumit, MOST-i do të ketë 1.500 vëzhgues, duke përfshirë edhe disa ekipe të lëvizshme, dhe do të bëjë një aktivitet paralel të nxjerrjes së rezultateve në një mostër prej 33 për qind nga numri i përgjithshëm i vendotimeve. Qendra për liri – CIVIL do ta vëzhgojë referendumin me 250 deri në 300 vëzhgues të akredituar.

## **XI. AKTIVITETET E MVR-SË SË ODIHR-IT**

MVR-ja e ODIHR-it e filloi punën e saj më 27 gusht në Shkup. Shefi i misionit është takuar me kryetarin e shtetit, kryeministrin, kryetarin e Kuvendit, ministrin e punëve të jashtme, përfaqësuesit e partive politike, KSHZ-së, Gjykatës Kushtetuese, mediave, organizatave të shoqërisë qytetare, Misionit të OSBE-së në Shkup dhe të bashkësisë ndërkombëtare në vend. MVR-ja ka vendosur kontakte me palët e përfshira në procesin zgjedhor në të gjitha nivelet. Kuvendi Parlamentar i Këshillit të Evropës (KPKE) planifikon të dërgojë një delegacion vëzhgues për ta vëzhguar ditën e referendumit.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.  
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*